



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 686/ 10 prot.

Datë 02 .04.2026

**V E N D I M**  
**Nr. 465 /2026**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 02.04.2026, mori në shqyrtim çështjen me,

**Objekt:** Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr.377/2026, datë 11.03.2026, për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar ”, Shërbime, me Nr. REF-77323-02-24-2026, me objekt “Shërbim Interneti dhe Telefon, për Bashkinë Vlorë dhe Institucionet në varësi” me fond limit 1.333.333 Lekë pa TVSH, për tu zhvilluar me datë 12.03.2026 nga autoriteti kontraktor Bashkia Vlorë.

**Ankimues:** Operatori ekonomik “NISATEL” ShPK me NIPT K26330201T, Adresa: Lagjja Pavarësia Kulla I, Rrethi Skelë kati 2, Vlorë.

Operatori ekonomik “VODAFONE ALBANIA” ShA me NIPT K11715005L, Adresa: Autostrada Tiranë-Durrës, Rr. Pavaresia, Nr.61, Kashar Tiranë.

**Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Vlorë.  
Adresa: Sheshi “4 Heronjtë”, Rruga “Osman Haxhiu” Vlorë.

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

## **Vëren:**

### **I**

#### *Rrethanat e çështjes*

I.1. Me Vendimin Nr.377/2026, datë 11.03.2026, Komisioni i Prokurimit Publik vendosi:

1. Të mbyllë çështjen për ankesën e operatorit ekonomik NISATEL ShPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar” Shërbime, me Nr. REF-77323-02-24-2026, me objekt “Shërbim Interneti dhe Telefon, për Bashkinë Vlorë dhe Institucionet në varësi” me fond limit 1.333.333 Lekë pa TVSH, për tu zhvilluar me datë 12.03.2026 nga autoriteti kontraktor Bashkia Vlorë.

2. Të mbyllë çështjen për ankesën e operatorit ekonomik VODAFONE ALBANIA ShA për procedurën e prokurimit sipërcituar.

3. Autoriteti kontraktor të modifikojë dokumentet e procedurës së prokurimit duke përpiluar shtojcën sipas vendimmarrjes së KSHA-së dhe publikuar në SPE.

4. Autoriteti Kontraktor brenda 5 ditëve të njoftojë KPP-në mbi veprimet e ndërmarra në përputhje me konstatimet e këtij vendimi.

5. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifëve financiare të paguara nga operatorët ekonomikë “NISATEL ShPK” dhe “VODAFONE ALBANIA ShA.

6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën ardhur me shërbim postar me nr. 2388/12 prot., datë 24.03.2026, protokolluar me tonën nr. 686/7 prot., datë 30.03.2026, me objekt “Zbatim Vendimi”, autoriteti kontraktor informon se ka zbatuar vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit sipërcituar.

## **Komisioni i Prokurimit Publik**

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

### **Arsyeton**

II.1. Me shkresën ardhur me shërbim postar me nr. 2388/12 prot., datë 24.03.2026, protokolluar me tonën nr. 686/7 prot., datë 30.03.2026, me objekt “Zbatim Vendimi”, autoriteti kontraktor informon se ka zbatuar vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit sipërcituar.

Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe verifikimeve të kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, konstatohet se autoriteti kontraktor ka publikuar shtojcën përkatëse, për modifikimin e dokumentave të tenderit të procedurës së mësipërme të prokurimit.

II.2. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor *Bashkia Vlorë*, ka zbatuar vendimin Nr. 377/2026, datë 11.03.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

Përsa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### **Vendos**

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, Shërbime, me Nr. REF-77323-02-24-2026, me objekt “Shërbim Interneti dhe Telefon, për Bashkinë Vlorë dhe Institucionet në varësi” me fond limit 1.333.333 Lekë pa TVSH, për tu zhvilluar me datë 12.03.2026 nga autoriteti kontraktor Bashkia Vlorë.

2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Gjergj Mersini**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

